

Përshëndetje,

Lutem gjeni ne vijim informacionin e kërkuar.

1/ Kontrolli Mjekësor Bazë “Si je”, si janë të dhënat? Sa qytetarë kanë kryer CHECK-UP-in përgjatë 1 viti?

- Për vitin 2022, në rang vendi janë kryer gjithsej 454,828 Kontrollle Mjekësore Bazë.

2/Cilat janë grupmoshat që e kanë kryer CHECK-UP?

-Grupmosha e përfshirë në paketën e Kontrollit Mjekësor Bazë është 35-70 vjeç, e ndarë si më poshtë;

35-40 vjeç - 48,218 kontrolle

40-49 vjeç - 109,099 “

50-59 vjeç – 141,688 “

60-65 vjeç – 95,850 “

65-70 vjeç - 59,973 “

3/Sa “Check-Up” janë planifikuar dhe sa janë kryer gjatë vitit 2022?

-Për vitin 2022, në rang vendi janë planifikuar 475,000 Kontrollle Mjekësore Bazë, dhe janë kryer 454,828 kontrolle.

4/Cilat kontrolle mjekësore kryhen përmes këtij shërbimi?

-Paketa e Kontrollit Mjekësor Bazë, përfshin këta komponentë:

a) Vlerësim, këshillim, trajtim dhe ndjekjen për faktorët e stilit të jetesës;

i. Puna që kryen apo ka kryer;

ii. Ushqyerja;

iii. Konsumimi i duhanit;

iv. Konsumimi i alkoolit;

v. Niveli i stresit dhe depresionit .

b) Matje, vlerësim, këshillim, referim dhe ndjekje e parametrave fiziologjikë;

i. Tensioni arterial;

ii. Pesha trupore;

iii. Aktiviteti i zemrës.

c) Matje, vlerësim, këshillim, trajtim, referim dhe ndjekje e parametrave biokimikë;

i. Formula e gjakut;

ii. Hb, HCT, MCV, MCH, MCHC;

iii. Kolesterol total, HDL kolesterol, LDL kolesterol, trigliceride;

iv. Glicemia;

v. Feçe për gjak akult;

vi. Albuminuria, prania e qelizave, cilindrave, kristaleve në urinë;

vii. Bilirubinë totale dhe direkte ,transaminaza (SGPT, SGOT), përqendrimi i uresë në gjak, përqendrimi i kreatinës në gjak .

5/Sa është numri në total i qytetarëve që kanë përfituar këtë shërbim

Numri total i qytetarëve që e kanë përfituar këtë shërbim, që nga viti 2015 - 2022 është 2,523,419.

P.S. Ju bëjmë me dije se të dhënat e kërkuara janë të publikuara edhe në faqen zyrtare te Fondit, tek Raportet Vjetore , në linkun <https://fsdksh.gov.al/botimet-2/>